

VETËVENDOSJE!

KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM KOPJOJE!

GAZETË MUJORE | KORRIK 2005 | Nr. 2

Përse s'mund të jemi çfarë
duam të jemi?
Duam të jemi të lirë!

Bob Marley

Liria e qytetarëve dhe kufizimi

Gëzim Krasniqi

Zhvillimet aktuale politike në lidhje me përcaktimin e statusit të Kosovës janë alarmante, qoftë për nga dinamika e tyre, qoftë për nga drejtimi që kanë marrë. Tërë procesi është i bazuar në gjetjen e një konsensusi sa më të pranueshëm, apo më lehtë të imponueshëm nga bashkësia ndërkombëtare për të penguar jetësimin e sovranitetit të Kosovës. Si rezultat, sot jemi

e kombeve, dhe politikës shtypëse dhe agresionin. Dhe, bashkësia ndërkombëtare përmes organizimeve të ndryshme mbikombëtare, apo edhe përmes aleancash të ndryshme mes shteteve, është angazhuar vazhdimisht në përpjekjet për dënimin e kryerësve të krimeve dhe shkaktarëve të agresioneve. Të tilla janë rastet e trajtimit të Gjermanisë, Austrisë dhe Japonisë pas Luftës së Dytë Botërore nga ana e fuqive aleate, me ç'rast erdhi deri tek kufizimi i thek-

Për më keq, dhe sikur të mos mjaftonte vetëm kjo, sot dëgjojmë edhe disa diplomatë gjermanë (njëri prej tyre është ish-shefi i Zyrës Gjermane në Kosovë, Michael Schmunk) që në emër të "ndihmës dhe dashamirësisë" ndaj qytetarëve të Kosovës, na shpjegojnë sesi kufizimi i sovranitetit s'është gjë e keqe, ngaqë edhe populli gjerman e paska përjetuar një gjë të tillë pas Luftës së Dytë Botërore (!) Krahasime të tilla, për aq sa janë përpjekje për të krahasuar të pakrahasueshmet, janë edhe të rrezikshme dhe tendencioze. U mor vesh që gjermanët u privuan nga sovraniteti për shkak të krimeve të regjimit të Hitlerit, po ç'krim paskan bërë shqiptarët e Kosovës për t'u privuar nga sovraniteti dhe liria qytetare?!... "Krimi" i vetëm i shqiptarëve është fakti që ishin viktima të terrorit të shtetit të Serbisë dhe që angazhohen për lirinë e tyre dhe të vendit të tyre. Qëndrime të tilla të diplomatëve evropianë, e që fatkeqësisht nuk janë ta pakta, na bëjnë të kuptojmë më qartë orientimin e politikës ndërkombëtare karshi Kosovës dhe paktësojnë përpjekjen për të barazuar të gjithë në fajësimin për luftërat në ish-Jugosllavi - viktimat dhe kryerësit e krimeve.

Jo kufizime! Liri dhe vetëvendosje!

Baza e sovranitetit është në popull, është në vullnetin e qytetarëve. U takon qytetarëve të Kosovës të vendosin se çfarë shteti do të kenë, dhe ku do të jetë e ardhmja e tyre. Sovraniteti i një vendi është shprehje e zgjedhjes së lirë dhe vetëvendosjes së qytetarit. Zhvillimi dhe qëndrueshmëria politiko-ekonomike e një vendi janë të mundura vetëm me zgjerimin e lirisë të qytetarëve. Përpjekjet e tanishme për kufizim e sovranitetit të Kosovës janë përpjekje për kufizim të lirisë së qytetarëve, është përpjekje për kufizim të mundësive për zhvillim. Vetëvendosja për qytetarët e Kosovës është e paalternativë. Liria qytetare nuk është standard. Sovraniteti nuk është çështje meritokracie. Ai buron nga vullneti i qytetarëve dhe u takon atyre. Ai është e drejtë. Andaj, çdo zgjidhje e mundshme e statusit të Kosovës që nuk merr për bazë vullnetin e qytetarëve dhe, që në çfarëdo mënyre kufizon shprehjen e lirisë të vullnetit politik të tyre, është e paqëndrueshme. Mobilizimi qytetar për të vetëvendosur është më se i domosdoshëm. Kërkesa e qytetarëve të Kosovës është e qartë: Jo kufizime! Liri dhe vetëvendosje! Duke vetëvendosur sot, projektojmë të ardhmen e lirë dhe krijojmë mundësinë.



Foto: Frezeart Galica - Orij

dëshmitarë të propozimeve për "pavarësi pa sovranitet", "sovranitet të kufizuar", "pavarësi të kushtëzuar", e shumë e shumë çuda të tilla. Agjenda politike për Kosovën, e hartuar nga bashkësia ndërkombëtare dhe e përkrahur pa rezervë nga IPVO-të, qysh në fillim ka përfshirë një gjë: të drejtën e qytetarëve të Kosovës për vetëvendosje. Pra, ajo çfarë po emërohet si fazë e përcaktimit të statusit politik të Kosovës, e që pritet të fillojë në vjeshtë përmes negociatave, është proces politik që zhvillohet në mes bashkësisë ndërkombëtare, IPVO-ve dhe Serbisë. Qytetarët e Kosovës janë të përjashtuar nga ky proces. Atyre po u pamundësohet të ushtrojnë të drejtën e tyre të pamohueshme për të vendosur vetë për të ardhmen e vendit. IPVO-të, të themeluara nga UNMIK-u, në emër të ushtrimit të demokracisë dhe përfaqësimit të qytetarëve, janë shndërruar në faktorin kryesor të mohimit të së drejtës së qytetarëve për vetëvendosje, duke u vetëmandatuar për të negociuar për diçka që nuk negociohet në asnjë mënyrë. Vetëvendosja është shprehje e lirisë së qytetarit, dhe si e tillë ajo nuk negociohet!

Historia e shekullit të njëzet është e mbushur përplot me viktima njerëzore, krime dhe shkatërrime materiale, si rezultat i përplasjes së vazhdueshme në mes thirrjes dhe angazhimit për liri të popujve

suar i sovranitetit të këtyre vendeve. Ky ishte çmimi që këto vende duhej paguar për shkak se ishin shkaktarët kryesor të tragjedisë më të madhe njerëzore. Prania ushtarake dhe civile e aleatëve në këto vende u instalua me qëllim të përshpejtit të procesit të denacifikimit të plotë të tyre.

Në fund të shekullit njëzet, makineria ushtarake serbe e udhëhequr nga Milosheviqi terrorizoi popujt, që dikur ishin pjesë e ish Jugosllavisë, duke filluar që nga lufta në Kroaci dhe Bosnjë, për të përfunduar me luftën në Kosovë. Në krahasim me zhvillimet politike pas Luftës së Dytë Botërore që i sipërpërmendëm, qëndrimi dhe sjellja e bashkësisë ndërkombëtare në këtë rast, është sa absurde aq edhe në kundërshtim me çdo rregull morali. Nëse dikur agresori dhe shkaktar i luftës (rasti i Gjermanisë në Luftën e Dytë Botërore) u privua nga shumë kompetenca shtetërore dhe të drejta politike, me një fjalë, iu suspendua sovraniteti, sot po ndodh e kundërta. Paradoksalisht, sot bashkësia ndërkombëtare është vënë në lëvizje për mbrojtje me çdo kusht të sovranitetit dhe integritetit territorial të Serbisë. Thirrja e vazhdueshme dhe e vendosur nga qendrat politike botërore për mosndryshim të kufijve, është qëndrimi që ka bashkësia ndërkombëtare në raport me Serbinë - shkaktarin e luftërave në Ballkan.

Sepse

Vetëvendosje, sepse çdo popull ka të drejtë të zgjedh lirisht rrugën e ndërtimit të fatit kolektiv.

Vetëvendosja është kushti themelor i lirisë. Gjithçka më pak është joliri. Joliria është e padrejtë. Padrejtësia është e papranueshme. Luftoje padrejtësinë!

Vetëvendosje, sepse liria kolektive është kushti fundamental i lirisë individuale.

Vetëvendosje, sepse burim i vetëm i sovranitetit është populli dhe askush tjetër.

Vetëvendosje, sepse çdo popull ka të drejtë të dekolonizohet.

Vetëvendosje, sepse sa herë kanë vendosur tjerët për ne, e jo ne për veten, kemi qenë të shtypur.

Vetëvendosje, sepse zgjidhja është liria, dhe ajo ndodh vetëm atëherë kur kjo çështje nuk lihet në ndërgjegjen e pushteteve në Beograd.

Vetëvendosje, sepse problemi zgjidhet jo atëherë kur synohet ndryshimi i opinionit të brendshëm serb për Kosovën, por atëherë kur Kosova pushon së qeni objekt i këtij opinioni.

Vetëvendosja është goditje e fuqishme ndaj çfarëdo aspiratash hegjemoniste.

Vetëvendosja është mbyllje e shtegut të së keqes.

Vetëvendosja ndikon në denacifikimin e Serbisë.

Vetëvendosje, sepse ky është minimumi i kompensimit moral për padrejtësinë shekullore, represionet e vazhdueshme, shkeljen e pandërprerë të dinjitetit, qindra mijëra dhunime dhe dhjetëra mijëra vrasje, shkatërrime dhe dëme të përgjithshme.

Vetëvendosje, sepse kjo është diçka e natyrshme: është gjë e pritshme të vendosim në interes të vetes më shumë seç do ta bënte këtë tjetërkush dhe gjithkush tjetër për ne.

Vetëvendosje! Pa kusht. Deri në shkëputje përfundimtare. Deri në çlirimin e plotë të vendit.

Editorial

Në vendin tonë, proceset fundamentale sociopolitike janë të 'mbi-imponuara'. 'Interesat' e popullit gatohen nga tjetërkush dhe tjetërkund dhe i servohen popullit. Dëshirat i projektohen, opinionet i krijojnë. I tërë ky inxhiniering kërkon alamet mekanizmesh për të implementuar një projekt që s'është yni. UNMIK-u nuk ka leverdi që krejt këtë punë ta bëjë i vetëm: ai ka themeluar një varg institucionesh politike vendore për këtë punë. Kushti ekzistencial i tyre është dëgjueshmëria dhe ndihmesa që ato japin përgjatë këtij rrugëtimi.

Krejt kjo ndodh për një arsye të thjeshtë: populli ynë nuk mund të vendosë për vetveten. Ai nuk është realizues i intereseve të veta. Pra, atij i është mohuar liria. Të vetëpërcaktosh interesat, të mund ta ushtrosh lirinë e mundësive dhe të vendosësh vetë për kahet e zhvillimit - kjo është vetëvendosja. E domosdoshmja e munguar. E drejta e pandërmjetësueshme dhe e nevojshme e pakompensueshme. Vetëvendosja është e pazëvendësueshme.

Kahet e rrjedhave politike, të cilave u janë nënshtruar institucionet tona janë negacioni i këtij interesi thelbësor të popullit tonë. Aspak e rastësishme, sepse s'mund të ndodh ndryshe: kushti ekzistencial i këtyre institucioneve prodhon domosdoshmërisht hendekun e pakapërcyeshëm ndaj 'qytetarit'. Krejt çka i kërkohet këtij të fundit është plotësimi i njëfarë letreje, në të cilën, pasi e shënon emrin e një partie politike aty, e fut në një kuti, dhe mu këtu kompletohet tregimi i iluzionit të demokracisë në Kosovë. Ky hendek për gjashtë vite ka prodhuar pashmangshëm dy pasoja themelore: rritjen gjeometrike të pasurisë së pushtetarëve dhe thellimin e pandalshëm të varfërisë së 'qytetarëve'.

Prandaj, problemi është sistemik për nga natyra. Problemi sistemik rregullisht kërkon zgjidhje sistemike. Të kërkosh që kjo zgjidhje të jetë brendainstitucionale, është, siç do të thoshte mendimtari i madh gjerman, Imanuel Kant, njësoj sikur të shpresosh ta presësh qumështin me sitë përderisa je duke bërë mundin shumëfish të kotë të mjeljes së një çjapi!

Çfarëdo përpjekje, pra, për t'i dhënë fundin këtij sistemi antidemokratik, është domosdoshmërisht jashtë kushteve që i vë ai. Pranimi i kushteve të tij është mbi-jetesa e tij. Kushti i të qenit të tij është mohimi i interesit fundamental të popullit. Jeta e sistemit është mumifikimi i 'qytetarit'. Prandaj vdekja e tij është lindja e popullit. Vetëvendosja. Gjithçka tjetër është joliri. Padrejtësi e papranueshme.

Glauk Konjufca

Intervistë me Shinasi A. Ramën, Ph.D.

Shumica e liderëve politik janë duke u marrur me pompa benzine e kontrabandë dhe s'kanë kohë të merren me të drejtën e Kosovës për vetëvendosje!

Intervistuar nga Gëzim Krasniqi

Shinasi Rama është profesor i shkencave politike në New York University. Në Rambuje ka qenë këshilltar i delegacionit kosovar dhe ka rekomanduar që të mos nënshkruhet marrëveshja...

1. Kohët e fundit nga qendra të ndryshme politike dhe politikanë të huaj dëgjojmë gjithnjë e më shumë propozime për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës. "Pavarësi e kushtëzuar", "pavarësi pa sovranitet", "sovranitet i kufizuar", "status evropian" - janë disa nga propozimet për statusin e Kosovës. Çka në të vërtetë nënkuptojnë propozime të tilla për Kosovën? Dhe, sipas mendimit tuaj, një vend a është shtet nëse nuk ka sovranitet?

Rama: Një nga kushtet themelore për të qenë shtet është që të njihesh si i tillë formalisht nga shtetet e tjera, pavarësisht nga marrëdhëniet preferenciale që lidh ky shtet me shtetet e tjera. Dhe kjo njohje, sovraniteti i jashtëm, do të thotë jo vetëm që shteti formalisht është i barabartë dhe hyn në marrëdhënie të barabarta me shtetet e tjera, por do të thotë gjithashtu që shteti i njihet sovraniteti i brendshëm nga shtetet e tjera dhe nga qytetarët e vet. Çka shteti bën me sovranitetin e vet mandej, pra, nëse një shtet vendos që të kalojë një pjesë të autoritetit të tij tek një qendër tjetër vendim-marrëse është çështje tjetër. Në këtë drejtim, "sovraniteti i kufizuar", një koncept brezhnjevi i shpikur mbas Pranverës së Pragës, është një përpjekje në drejtim negativ, d.m.th. një ripërkufizim i sovranitetit për të kontrolluar e për të shtrënguar një shtet që të bëjë si do shteti më i fuqishëm në fusha kyçe të veprimtarisë shtetërore. Nga ana e sovranitetit mbi fusha prej të cilave heqet dorë me vetëdije kemi konceptin e 'pooled sovereignty' që i referohet natyrës së

autoritetit që ka Brukseli, që e tejkalon atë të shteteve anëtare të Bashkësisë Evropiane. Mirëpo, problemi është se cili shtet do t'i ketë ato autoritete që i takojnë por që nuk do t'i ketë shteti i Kosovës?

2. Duke pasur parasysh zhvillimet në politikën ndërkombëtare si dhe qëndrimet e institucioneve politike të Kosovës, a mendoni që, në emër të "statusit evropian" dhe "pavarësisë së kushtëzuar", Kosovës i kanoset rreziku real i integritetit në BE si pjesë e Unionit Serbi-Mali i Zi?

Rama: Pavarësia e kushtëzuar është tjetër gjë prej statusit evropian. Pavarësia e kushtëzuar ka terma të përcaktuar qartë kur do të bëhet e pakushtëzuar, të paktën formalisht. Puna është se, në rastin tonë, kushtet janë të tilla që nuk mund të përbushen pa e shkatërruar në thelb konceptin e shtetit vetë. Në lidhje me statusin evropian, kjo është një përrallë që nuk ka kurrfarë baze reale e shprese realizimi, njësoj si çika në përrallë që don ta kalojë ylberin. Jo vetëm Europa vetë është në një situatë të vështirë politike prej të cilës nuk mundet asesi që të dalë shpejt, por Kosova nuk i ka kushtet as ekonomike, as politike e as shoqërore për të qenë e gatshme për të hyrë në Europë. Mua më duket se "statusi evropian" është një hile për të na detyruar që të pranojmë qëndrimin në Serbi, kinse si fazë tranzitore në atë rrugë drejt Evropës që na thuhet se kalon kah Beogradi.

3. "Lëvizja Vetëvendosje!" kohë më parë ka filluar të fushatojë për të drejtën e qytetarëve të Kosovës për vetëvendosje të menjëhershme dhe të pakusht për të ardhmen politike të vendit. Sipas konceptit të kësaj lëvizjeje, nëse nuk realizohet e drejta e qytetarëve të Kosovës për vetëvendosje dhe institucionet kosovare pranojnë të

hyjnë në bisedime me Serbinë për statusin, atëherë Kosova përsëri do të mbetet nën sovranitetin serb. Çfarë është opinioni juaj në lidhje me këtë?

Rama: Fushata e lëvizjes "Vetëvendosje!" është një lëvizje qytetare për t'u përsëritur e mbështetur fuqimisht nga të gjithë, anipse shumica e liderëve politikë janë duke u marrur me pompa benzine e kontrabandë e s'kanë kohë të marren me këtë punë. Me serbët duhet të bisedohet se ato janë fqinjët tanë, por më parë duhet që ato të flasin hapur e të pranojnë krimet shekullore, dhunën, shkatërrimin, përdhunimet, të zhdukurit, e traumat që na i kanë shkakuar pa ndërprerje, e që askush nuk po i përmend më. Me serbët duhet biseduar kur ta njohin vullnetin e popullit të Kosovës paraprakisht, sepse, nuk ka pikë dyshimi se çdo bisedim për statusin që nuk njihet paraprakisht vullnetin e popullit të Kosovës të shprehur me një referendum popullor, do të sjellë më shumë probleme se zgjidhje. Nga ana tjetër, duhet të mbajmë parasysh se, edhe nën dhunën serbe, populli i Kosovës ka votuar në një referendum për pavarësinë. Mirëpo gjërat kanë ndryshuar qysh atëherë dhe tash nuk shtrihet më thjeshtë pavarësia, por edhe mundësia e shpërbërjes së Jugosllavisë përgjatë linjave etnike. Si po shkojnë gjërat, pasi të merret vesh mirë përfundimi i zgjedhjeve në Shqipëri, e pas përfundimit të rivlerësimeve që po bëhen e që duket se po çojnë në konkluzionin se shpërbërja e Jugosllavisë duhet të zgjidhet - sa më shpejt, aq më mire - atëherë mund të shohim një përpjekje nga shtetet amë dhe nga fuqitë e interesuara për të zgjidhur problemin me vetëvendosje, por është edhe mundësia, nën një formë pavarësimi të kushtëzuar, e ndarjes faktike të Kosovës përgjatë vijave etnike dhe bisedimet atëherë nuk do të jenë vetëm dypalëshe por edhe me prezençën e palëve të interesuara, direkt apo indirekt.

Koment

Për tri ngjarjet më të rëndësishme politike të muajit qershor

Shkëlzen Gashi

1. Ngjarja më e rëndësishme e muajit qershor është vizita që nënsekretari amerikan, Nicholas Burns, i bëri vendit tonë. Pas takimit që ai pati me Kryetarin e Kosovës, Ibrahim Rugovë, ky i fundit tha se krerët e institucioneve të vendit kanë marrë premtime se gjatë këtij viti do të merren vendime për Kosovën dhe janë siguruar për përkrahje nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për proceset që po ndodhin në Kosovë. Fakti se këtë vit do të merren vendime për Kosovën nuk do të thotë se vendimet që do të merren do të jenë në përputhje me vullnetin e popullit të Kosovës. Këtë më së miri e dëshmon vetë deklarata e Nicholas Burns-it se: "Statusi final i Kosovës nuk mund të vendoset unilateralisht nga njëra palë ose si rezultat i përdorimit të forcës". E, kjo do të thotë se nuk do të ketë shtet të pavarur dhe sovran - vullneti i shprehur i popullit të Kosovës - dhe as më shumë se autonomi substanciale e më pak se pavarësi - opcioni i Beogradit zyrtar, por zgjidhja do të jetë e ndërmjetme. Pra, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përkrahin proceset që po ndodhin në Kosovë, e kjo do të thotë se do të përkrahin proceset që janë në kundërshtim me vullnetin e popullit të Kosovës, sepse proceset që po ndodhin në Kosovë janë të tilla.

2. Zvicra përkrah pavarësinë e Kosovës. Në fakt, Ministria e Punëve të Jashtme të Zvicrës ka deklaruar se përkrah pavarësinë për Kosovën. Fill pas kësaj, parlamentarë zviceranë kanë kërkuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Zvicrës që të jep sqarime përkitazi me këtë deklaratë. Në sqarimin e saj, ajo ka thënë se përkrahim pavarësinë, por pa sovranitet. Po të mos ishte sqarimi i saj, do të thelloheshin edhe më iluzionet se jemi një hap më afër pavarësisë, gjegjësisht njohjes formale të saj. Pavarësinë pa sovranitet, siç duket, e përkrahin edhe

ish-at që deklarohen për pavarësi, por s'e potencojnë se janë për sovranitet, siç është rasti, ta zëmë, i ish-presidentit amerikan Bill Clinton, ish-sekretares amerikane të shtetit Madeline Albright, ish-ambasadorit Richard Holbroke, ish-komandantit të NATO-s për Evropë Wesley Clark, ish-kryeadministratorit për Kosovë Bernard Kushner... Ç'është e vërteta, njëri nga të sipërpërmendurit, Bernard Kushner, ka deklaruar se është për pavarësi pa sovranitet...

3. Qeveria e Kosovës dhe partitë politike kanë reaguar përkitazi me rezolutën e fundit të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës, ku thuhet se Kosova është pjesë e Serbisë dhe Unionit Serbi-Mali i Zi. Reagimi i tyre është i vonshëm. Tepër i vonshëm. Është dashur të reagohej dhe ky reagim të jetë i vazhdueshëm që kur Këshilli i Evropës në Feira, në qershor të vitit 2000 ka vendosur për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, e Kosova ka qenë paraparë të jetë brenda RFJ-së, apo kur Komisioni Europian, me 4 prill të vitit 2002 ka miratuar raportin e parë vjetor mbi Procesin e Stabilizim Asociimit të BE-së, ku është vendosur që Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Republika Federale e Jugosllavisë dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë të jenë pjesëmarrësit e këtij procesi. Kosova prapë brenda RFJ-së. Po ashtu, është dashur të reagohej kur në agjendën e Samitit të Selanikut për Ballkanin Perëndimor, BE-ja ka përsëritur mbështetjen e plotë për implementimin e Rezolutës 1244. Institucionet dhe partitë politike nuk kanë reaguar as për vendimin e Këshillit të Evropës të datës 14 qershor 2004 mbi parimet, prioritetet dhe kushtet, të cilat janë të përfshira në Partneritetin Evropian me Serbinë dhe Malin e Zi, ku Kosova është e inkuorporuar si pjesë e Serbisë dhe Malit të Zi.



Aktivitetet tona

Me 1 qershor, nën organizimin e organizatës "Thirrjet e Nënave" dhe mbështetjes së KAN-it ka filluar pjesa e dytë e fushatës "Të gjithëve na mungojnë" për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur në Kosovë. Në dhjetë billboarda dhe në dhjetë city-lights të kryeqytetit janë vendosur emrat e të gjithë personave të pagjetur nga Kosova, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare apo tjetërfare.

Me 10 qershor 2005 banorë të Reçakut bashkë me aktivistë të KAN-it në ndërtesën përballë selisë së UNMIK-ut kanë vënë një çarçaf me emrat e 20 ekzekutorëve dhe urdhëruesve të drejtpërdrejtë në masakrimin e 42 civilëve të fshatit Reçak. Pas katër orëve, policia ka tentuar të vjedh çarçafin dhe këtë e ka bërë pasiqë ka arrestuar dy banorë të fshatit Reçak: Agron Mehmeti dhe Nexhmedin Jakupi dhe katër aktivistë të KAN-it: Hysen Durmishi, Albin Kurti, Rrahman Durmishi dhe Arianit Kurti. Deri më tani policia ka vjedhur tre çarçafë.

Me 12 qershor 2005 në muret përreth selisë së UNMIK-ut janë shkruar parullat JO NEGOCIATA dhe VETËVENDOSJE! S'ka pasur arrestime.

Me 14 qershor 2005 pjesëtarë të Shërbimit Policor të Kosovës bashkë me disa molerë i kanë fshirë parullat. Po këtë ditë, 12 aktivistë i kanë shkruar parullat me ç'rast janë arrestuar që të gjithë nga SHPK-ja. Parullat janë fshirë përsëri.

Me 17 qershor 2005 është ndërmarrë aksioni për të shkruar parulla në të gjithë qytetin e Prishtinës. Aktivistët që kanë shkruar në hapësirën universitare: Liburn Aliu dhe Shkëlzen Gashi janë arrestuar nga policë të SHPK-së.

Po ashtu parulla janë shkruar edhe në komuna tjera të Kosovës si Ferizaj (ku është arrestuar aktivisti Sabit Azizi), Gjilan, Viti, Rahovec, Mitrovicë, Vushtrri, në afërsi të Graçanicës, Kaçanik etj.

Ndaj aktivistëve të VETËVENDOSJE!-s që kanë shkruar parulla janë ngritur deri më tani pesë kallëzime penale, si dhe tri të tjera lidhur me aksionin kundër vizitës së Drashkoviqit dhe vendosjes së çarçafit me emrat e të akuzuarve për pjesëmarrje në masakrën e Reçakut.

Lëvizja VETËVENDOSJE! me 27 qershor 2005, protestoi kundër vizitës së Vuk Drashkoviqit në Kosovë. Aktivistët e VETËVENDOSJE!-s të përkrahur edhe

nga një numër i qytetarëve hodhën vezë në drejtim të Drashkoviqit, njeriut bashkëpërgjegjës për krimet e shtetit të Serbisë në Kosovë, ish-zëvendëskryetarit të qeverisë së ish-Jugosllavisë gjatë bombardimeve të NATO-s, të mirënjohur për ideologjinë e tij neofashiste dhe çetnike. Shërbimi Policor i Kosovës intervenoi brutalisht duke arrestuar 19 aktivistë dhe të gazetarë. 17 aktivistë u liruan pas katër orëve, ndërsa dy të tjerë u mbajtën për 24 orë në burg. Procedura ndaj tyre vazhdon. 'Procedura' e VETËVENDOSJE!-s ndaj pushtetit jodemokratik po ashtu vazhdon. Deri në vetëvendosje!

Lëvizja VETËVENDOSJE! prej 29 qershorit 2005, filloi me radioemisionin e përdyjavshëm "Përballja" i cili emitohej në rreth 30 radiostacione lokale anekënd Kosovës. Emisioni ka temën qendrore, prezantimin e aktiviteve të VETËVENDOSJE!-s, anketën me qytetarë dhe komentim për ngjarjet kryesore politike. Emisioni i parë kishte për temë decentralizimin dhe në debatin për të morën pjesë anëtarë i kryesisë së PDK-së, Jakup Krasniqi, ministri për administratë dhe qeverisje lokale, Lutfi Haziri, dhe aktivisti i VETËVENDOSJE!-s, Gëzim Krasniqi.

Statusi 'simptomatik' i SHPK-së dhe IPVQ-ve: një vështrim në teorinë e personalitetit autoritar

Glauk Konjufca

Në psikologji dhe mjekësi ekziston një term i përdorimit të gjerë - simptoma. Teoria psikoanalitike e 'personalitetit dinamik' e koncepton simptomën si manifestim të shndërruar të përmbajtjeve të ndrydhura kryesisht me bazë libidinale. Personi ndrydh një dëshirë të fuqishme impulsive duke menduar që e ka zhbërë atë. Në të vërtetë, ai s'ka bërë tjetër veçse e ka kaluar atë në një medium që s'është i njohur për gjendjen tonë të vetëdijshme. Dhe jo vetëm kaq: përmbajtjet, të cilat kujtuam se i zhdukëm duke i shtypur, vazhdojnë të bëjnë presion, me ç'rast gjejnë manifestime simptomatike, duke filluar që prej motiveve e deri te sjellja.

Në mjekësi simptoma ka një kuptim të ndryshëm. Njëra ndër ato domethënie kryesore që ka simptoma, e që do të mund të na hynte në punë për shpjegimin e mëtejshëm, ka të bëjë me kuptimin e manifestimit (kryesisht të jashtëm) që shkakton ndonjë ndryshim psiko-fizik në organizëm, e të cilin ne e quajmë 'sëmundje'.

Të dyja këto kuptime të simptomës (kuptimin psikoanalitik dhe atë mjekësor) i përmbledh zberthimi i shkëlqyer i filosofit gjerman, Martin Heidegger, te *magnum opus*-i i tij, *Sein und Zeit*, që sipas mendimitarit të shquar Jürgen Habermasit, paraqet arritjen më të madhe filozofike që prej *Phänomenologie des Geistes* të F.W.G. Hegelit. Zberthimi i Heideggerit shenjon aspektin formal të kuptimit më të përgjithshëm të simptomës: 'duke e shfaqur vetveten, simp-

toma tregon për diçka, e cila si e tillë nuk e shfaqë vetveten (sëmundja)'. Shkaku i vërtetë i simptomës është sëmundja - ai ndryshim kimiko-fizik në organizëm, i cili prodhon manifestimet e dukshme. Simptoma është dukja e sëmundjes, e jo shkaku i saj. Diagnostifikimi i sëmundjes bëhet duke hetuar mënyrën e manifestimeve të simptomës.

Në realitetin sociopolitik kosovar a s'është UNMIK-u vetë sëmundja? Si rrjedhim, institucionet e krijuara nga UNMIK-u (IPVQ-të dhe SHPK-ja) a nuk janë pikërisht simptoma e saj? Në një kohë kur IPVQ-të shërbejnë vetëm për implementimin sa më të suksesshëm të agjendës politike të UNMIK-ut dhe kur SHPK-ja s'bën tjetër veçse zbaton me zell adhurues urdhërat e prerë të tij, statusi i këtyre dy instrumenteve të regjimit antidemokratik është kryekëput 'simptomatik'. Ky status ka filluar të kristalizohet përfundimisht që kur policia e UNMIK-ut nuk përballet me pakënaqësinë e popullit ndaj padrejtësisë. Sëmundja filloi dhe vazhdon ta fsheh vetveten nëpërmjet simptomës. Që prej datës 30 gusht të vitit të kaluar policia ndërkombëtare nuk përballet me protestuesit, të cilët demaskojnë padrejtësinë e sistemit. Prandaj, IPVQ-të ose janë krijuar për t'i shërbyer UNMIK-ut, ose, ndryshe, nuk do të ishin themeluar fare nga ky regjim! Kushtii i ekzistencës së tyre është gjendja 'simptomatike'.

Sa i përket SHPK-së, një zberthim më i detajshëm do të ishte fort i nevojshëm. Për mua nuk kishte rast më praktik për të kuptuar gjithë atë mori studimesh në fushën e 'karakterit autoritar' se sa ai që

më rastisi në stacionin qendror të SHPK-së. Kjo ndodhi kur 12 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! u arrestuan gjatë protestimit të padhunshëm derisa po shkruanim parullën - 'JO NEGOCIATA. VETËVENDOSJE!'.

Sipas filosofit dhe sociologut të madh gjerman me prejardhje hebreje, Thodor W. L. Adorno, përfaqësues me nam i Shkollës së Frankfurtit, te disa njerëz ekziston i ashtuquajtur 'sindrom i personalitetit autoritar'. Këta janë një kategori njerëzish, personaliteti i të cilëve ngërthen një kompleks vetish dhe prirjesh. Së pari, këta njerëz sigurinë e tyre e gjejnë kryesisht në nënshtrimin ndaj autoritetit. Si rrjedhim, raportit i tyre ndaj autoritetit është bindja dhe adhurimi jokritik. Njerëzit e tillë, sipas Adornos, jo vetëm janë të prirur të zbatojnë urdhërat të dhëna nga autoriteti, por, ç'është më e keqja - dhe mu këtu qëndron thelbi i problemit - ata i cilësojnë gatishmëria e përbrendësimit formal të strukturës së urdhërit, e pra, zhveshja e tij nga çfarëdo përmbajtje etike. A s'janë të gjitha këto veti pjesë integrale të personalitetit të shumicës së policëve të SHPK-së? Me mbi 95 % të të gjithë policëve me të cilët kemi pasur rastin të konfrontohemi, arsyetimi i tyre ndaj veprimeve të pështira që bënin (p.sh kur i vodhën 3 çarçafë radhazi, ku ishin të shkruar emrat e të dyshuarve për pjesëmarrje në masakrën e Krushës së Vogël, në atë të Gjakovës dhe Reçakut) ishte: 'ne zbatojmë urdhërat', 'kështu më ka ardhur urdhëri', 'shkoni dhe flisni me ata që na japin urdhërat', 'ne s'kemi ç'të bëjmë'... dhe me të tilla arsyeime, të denja për një studim

shumë më të gjerë se ky shkrim modest. Çdo të thotë, në të vërtetë, ta marrëdh urdhërin si detyrë absolute? Ç'kuptim ka zbatimi i tij duke e zhveshur atë nga çfarëdo përmbajtje etike? Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe disfatës që pësoi nazizmi, shumë kriminelë nazistë, ushtarë dhe oficerë të Führerit u gjykuan në Nürnberg për krimet monstruoze që kishin bërë. Gati që të gjithë prej tyre kishin një arsyetim standard: 'ne vetëm kemi zbatuar urdhërat!'. Edhe policët e SHPK-së 'vetëm zbatojnë urdhërat'. Ata nuk janë për ta zbatuar ligjin por urdhërin. Diferenca ndërmjet asaj që është e drejtë dhe asaj që është urdhër mund të jetë e ndryshme në situata që dallojnë nga njëra-tjetra dhe të prodhojnë efekte jo të njëjta varësisht konteksteve. Për shembull, ajo dallon ndërmjet një ushtari nazist dhe një polici të SHPK-së. Por, nëse për ne s'është aq domethënëse diferenca, gjithsesi duhet të jetë brengosëse prania. Jo rastësisht, teoretet e personalitetit autoritar personin, të cilin e shquan ky sindrom e quajnë 'fashist potencial' (*'stand by fascist'*). Sipas këtyre teoretëve, veçori tjetër e karakterit autoritar del të jetë edhe besimi i verbër dhe konformizmi intensiv ndaj autoritetit epror dhe, prandaj, sjellja përcmuese dhe agresive ndaj vartësve ose njerëzve prej të cilëve nuk varet. Kjo është arsyeja pse ky lloj individ, si rrjedhim i pamundësisë së manifestimit të çfarëdo pakënaqësie ndaj autoritetit përmbi, e zhvendos shfaqjen e agresivitetit të vartësit dhe të tjerët 'nën' të pikërisht në ambientin e sigurtë, i cili nuk e rrezikon pozicionin e tij të ndërmjetmë.

Në rastin e SHPK-së, këtë dukuri e kam vërejtur të shfaqet në dy nivele. Togerët manifestonin një agresivitet mjaft të lartë ndaj vartësve të tyre (policëve të thjeshtë) duke u bërë titur atyre me zë të lartë e duke i qortuar (shpeshherë edhe me fjalë banale) për punën që s'e kishin kryer mirë. Një gjë e tillë në mënyrë ende më agresive manifestohej ndaj të arrestuarve. Dikush kërcënohej me mundësi sulmi fizik (p.sh shtrëngim i grushtit para fytyrës së të arrestuarit), pastaj me fjalë fyese (p.sh. - 'sa të ka paguar Serbia të bësh kështu') etj. Po t'i pyesni studiuesit e personalitetit autoritar pse ndodhte kjo gjë, ata do të shpjegonin se si pozicioni i togerit kërkon që, duke qenë i varur nga autoriteti i një oficeri ndërkombëtar, të mos mund ta 'ajrosë' agresivitetin e tij përveçse me ata prej të cilëve ai nuk varet, e të cilët janë policët e thjeshtë. Niveli tjetër karakterizonte vetë policin ordiner. Edhe pse dukshëm më të sjellshëm se eprorët e tyre togerë, për këta policë, i arrestuari shpeshherë shndërrohej në objektin e shkarkesës së pakënaqësive të ndrydhura ndaj eprorëve togerë. Shpesh më ka rastitur të dëgjoj krahasimet që u bëhen IPVQ-ve dhe SHPK-së me marionetat. Qyshdoqoftë, edhe pse aspak e pasaktë, gjetja paksa varferon përmbajtjen e çështjes: ajo vlen vetëm formalisht. Dallimi thelbësor është vetëdija. Disa njerëz jo vetëm që janë marioneta. Ata kanë pranuar vetëdijshëm të bëhen të tillë. Ata vazhdojnë të jenë marioneta. Ja pse përgjegjësia është e shumëfishtë. E pafalshme.

Padrejtësia, e drejta dhe UNMIK-u

Agon Hamza

"Drejtesia është virtyti i themelor i institucioneve shoqërore, ashtu siç është e vërteta në sistemin e mendimit", thotë John Rawls, në librin *A Theory of Justice*. Por, teoria, sado elegante dhe ekonomike të jetë, duhet refuzuar ose ripërpunuar nëse është e gabuar. Njësoj sikurse që ligjet e padrejta duhet shfuqizuar, sado efektive që ato mund të jenë, vazhdon Rawls, në elaborimin e tij për drejtësinë.

Në teorinë juridike, në kuptimin material të tij, ligji përkufizohet si akt i përgjithshëm juridik, i cili përmban norma të përgjithshme juridike, pavarësisht se cili organ e nxjerr atë. Është akt i përgjithshëm juridik, sepse ligji nuk parashihet zgjidhjen e rasteve konkrete, por nëpërmjet ligjit, në mënyrë të përgjithësuar parashihen zgjidhjet e shumë rasteve. Por, megjithatë, është akt më praktik se kushtetuta, sepse ai konkretizon dispozitat kushtetuese në fushat konkrete. Shikuar nga një aspekt tjetër, nxjerrja e ligjit është kodifikim i drejtësisë. Sepse, ligji bën rregullimin e një fushe shoqërore brenda një kornize juridike. E ky kodifikim është njëfarë tjetërsimi i drejtësisë. Kodifikimi i të drejtës zakonore në Romë u bë si pasojë e ndarjes klasore të shoqërisë. Plebejasit kerkuan që rregullat juridike zakonore të kodifikohen. Me këtë kodifikim, plebejasit synonin pengimin e hyrjes së patricëve në organet qeverisëse. Kështu u lind "Ligji i XII Tabelave". Ky kodifikim, si monumenti më i lashtë i të drejtës romake, paraqiste procesin e diferencimit pasuror të shoqërisë romake, krijimin e skllavërisë dhe formimin

e shtetit skllavopronar. Pas kodifikimit të së drejtës zakonore romake, juristët romakë i zbatonin me të madhe dispozitat e Kodit, ndonëse pllakat prej bakri, ku ishte shkruar teksti i ligjit, ishin humbur gjatë luftës me galët.

Njëri ndër klasikët e marksizmit, Friedrich Engels në librin *Anti-Dyring* thotë se "dhuna pjellë zotërimin, dhe zotërimi = fuqinë ekonomike". Ai këtu ben fjalë për dhunën si pjesë integrale e marrëdhënieve të padrejta në prodhim. Shkaku i kësaj dhune, thotë Engelsi, është përvetësimi i punës së tjetrit dhe i fuqisë punëtore të tjetrit. Klasa sunduese në Romë kodifikoi të drejtën zakonore me qëllim të legalizimit juridik të marrëdhënieve në prodhim (në atë periudhë ekzistonte forma latifundiste e prodhimit). Synimi dhe qëllimi i institucionalizimit të kësaj dhune prodhoi normat juridike, tërësia e së cilave paraqet të drejtën. Sidoqoftë, *Corpus Juris Civilis* (përmbledhja e ligjeve romake) mbetet baza juridike mbi të cilën për herë të parë pabarazia mori karakter legal.

Pabarazia qytetare e ka përcjellë njerëzimin në të gjitha formacionet ekonomiko-shoqërore. Në çdo formacion të organizimit shoqëror, pabarazia merrte vetëm formë tjetër, por asnjëherë nuk është zhdukur. Teoria marksiste-leniniste thotë se çdo luftë, në instancë të fundit, ka karakter klasor. Klasikët e marksizëm-leninizmit luftën e trajtonin si dukuri klasore dhe kategori historike, që fundamentohet mbi rendin ekonomik të sistemit eksploatues. Lufta paraqitet në atë shkallë të zhvillimit shoqëror kur paraqitet prona private, ndarja

klasore e shoqërisë dhe krijimi i shteteve. Si lufta të drejta, marksizëm-leninizmi konsideron luftërat nacionalçlirimtare dhe ato për mbrojtje nga sulmi i jashtëm. Në Kosovë u zhvillua luftë e drejtë. Ne bëmë luftë çlirimtare. Por, nuk arritëm të çlirohemi. Ne vazhdojmë të mos jemi të lirë. Ne jemi popull i kolonizuar. Ndaj nesh ushtrohet padrejtësi. Padrejtësia që ushtrohet çdo ditë ndaj nesh është e legalizuar në zinxhirin e dokumenteve me të cilat qeveriset Kosova, por që asnjëra nuk gëzon legjitimitetin e popullit të saj. Në Kosovë autoriteti suprem është Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Detyra e tij është zbatimi i Rezolutës 1244, dhe për këtë arsye, ai është bartës i funksionit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. PSSP-ja kujdeset që të gjitha proceset në Kosovë të jenë në këtë linjë të imponuar politike. Vullneti dhe urdhërat e tij kanë karakter ligjor, ndonëse akti më i lartë juridik në Kosovë është rregullorja. Për materializimin e Rezolutës 1244, PSSP ka në dispozicion KFOR-in, policinë e UNMIK-ut si dhe SHPK-në, e cila është instrument i dhunës për realizimin e urdhërave të policisë së UNMIK-ut. Për administratën civile dhe ushtarake (KFOR-in si krahu ushtarak) të UNMIK-ut, sistemi ligjor nuk paraqet pengesa për realizimin e qëllimeve të veta. Përveç dhunës joshitetore të organizuar si polici dhe ushtri, për zbatimin e së drejtës, ata kanë edhe monopolin e interpretimit të akteve juridike. Zbatimi i normave juridike, përkatësisht i së drejtës, është finalizimi i sendërtimit të rendit juridik. Zbatimi vullnetar i normës juridike

d.m.th. sjellja e subjekteve të së drejtës në bazë të rregullës parësore të normës juridike - dispozicionit. Kur subjektet i ushtrojnë sjelljet e veta në kundërshtim me dispozicionin, atëherë zbatohet rregulla detyruese e norms - sanksioni. Por, për t'u zbatuar sanksioni, është i domosdoshëm ekzistimi i dispozicionit. Ekziston një parim i përgjithshëm juridik, që nga e drejta romake, i cili thotë nulla poena sine legis (asnjë dënim nuk mund të shqiptohet nëse më heret nuk ka qenë i paraparë me ligj). Për UNMIK-un dhe policinë e saj (që nënkupton edhe SHPK-në) kjo nuk është aspak e rëndësishme. Ata përdorin sanksionin (që nënkupton përdorimin e dhunës ndaj subjekteve të së drejtës), pa marrë parasysh nëse ekzistojnë normat juridike apo jo. Për ta me rëndësi është që qytetarët (në Kosovë, banorët) të mos e ndërrojnë kahjen e procesit politik. Norma juridike nuk mund të zbatohet nëse fillimisht nuk interpretohet. Interpretimi është sqarimi i normës juridike, nëpërmjet të cilës vërtetohet kuptimi i saj i drejtë (*ratio legis*). Ekzistojnë krijuesit e së drejtës dhe interpretuesit e saj. Shkenca juridike sot njih disa interpretues të së drejtës. Përveç interpretimit nga organet zyrtare, e drejta sot interpretohet edhe nga subjektet e së drejtës dhe organizatat joqeveritare. Ndërsa, si interpretim autentik konsiderohet interpretimi i bërë nga organi ligjvënës. Në Kosovë, organi i vetëm kompetent për interpretimin e akteve juridike është Zyra Ligjore e UNMIK-ut. Kjo zyre bën interpretimin qëllimor (teleologjik) të akteve juridike. Ata ia

përcaktojnë qëllimin normës juridike; ata përcaktojnë raportet shoqërore, të cilat duhet t'i rregullojë ajo normë. Ky lloj interpretimi rëndom paraqet të kundërtën e synimit të ligjëvënësit për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore. Në shumë raste në Kosovë normat e pashkruara kanë fuqi të njëjtë juridike me ato të shkruarat. Në një ligjëratë të tij, filozofi Slavoj i ek shpjegon natyrën e këtyre normave. Ai thotë se normat e pashkruara, të cilat rregullojnë jetën tonë ekzistojnë edhe në vendet më totalitare (kujto Bashkimin Sovjetik në kohën e Stalinit), ndonëse mendohet se në ato shoqëri çdo raport është i rregulluar me norma juridike të shkruara. Ato nuk shprehin në mënyrë eksplicite, por, nëse dikush i shpreh ato, atëherë pason sanksioni. Në Kosovë këto norma sigurojnë mirëmbajtjen e procesit politik, si negacion i vullnetit të popullit të saj. Sistemi juridik nuk mund të ndryshohet si i mëvetshëm. Ky sistem nuk do ta sjellë lirinë dhe barazinë. Por, përkundrazi, ai do të vazhdojë t'i mohojë ato. Sistemi ekonomiko-shoqëror në Kosovë duhet të revolucionarizohet në kuadër të revolucionarizimit të përgjithshëm shoqëror. Revolucioni është domosdoshmëria e arrijës së sigurisë së përgjithshme. Sistemi ekonomiko-shoqëror i Kosovës (që nënkupton edhe atë juridik) duhet të ndërtohet në rrethana të reja, të cilat do t'i sillte revolucionin. Sistemi i ardhshëm i Kosovës duhet të ndërtohet në kushtet e barazisë së përgjithshme qytetare.

Shkruaj këto parulla:

Liri, jo standarde!

Agjensioni i
Korruptuar i
Mosbesimit

Qeshu rini qeshu,
por ata janë në pushtet

Liri për të gjithë!

JO NEGOCIATA
VETËVENDOSJE!

Të gjithë për secilin

Pushteti absolut
korrupton absolutisht

Jobs, not trainings

Knowingly
Taking
All

We don't need another tourist

Revolucion dhe Çlirim!



Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen dhe synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhedrejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

Kroi i Bardhë, nr. 76
Lagja Dardania
Prishtinë, Kosovë

038 541411
vetevendosje@hotmail.com
vetevendosje@yahoo.com
vetevendosje@gmail.com
www.vetevendosje.org

VETËVENDOSJE!

**KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM KOPJOJE!**

Graphic & design: Rrezeart Galica - Giqi

Sovraniteti

6. Kosova josovrane nuk mund të përfaqësohet në asnjë organizëm ndërkombëtar, rrjedhimisht nuk mund të mbrojë e përfaqësojë interesat e veta e as të shfrytëzojë benefitet e anëtarësisë në to. Viteve të fundit, tragjike është pamundësia e Kosovës të shfrytëzojë kreditë ndërkombëtare pranë FMN dhe BB (Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore) që do të mund të plasoheshin si mjete për biznesin kosovar me ulje drastike të normave të interesit - si parakusht për zhvillim ekonomik.

7. Të definuara si marrëdhënie mes shteteve, Kosova nuk ka dhe nuk mund të realizojë marrëdhënie ndërkombëtare (e as që do të ketë pa sovranitet) dhe realisht mbetet e izoluar. Rrjedhimisht, Kosova nuk ka ambasada, që ndër tjerash do të mund të mbronin interesat e kosovarëve në diasporë.

8. Sovraniteti, ose më mirë mungesa e tij, pamundëson Kosovës ta ketë kodin 2-3 shenjës dhe 3 shifror pranë ISO (Organizata Ndërkombëtare për Standarde), që ka aplikime të shumta në qarkullimin ndërkombëtar të fondeve dhe mallrave si dhe në komunikimin ndërkombëtar. (p.sh. S.W.I.F.T. kodi, kartelat kreditore, kodi për domenin në Internet, e deri te Bar kodi). Kjo gjë shkakton probleme dhe vështirësi të panumërta për kosovarët. Te qarkullimi i pagesave ndërkombëtare përmes sitemit S.W.I.F.T, çdo bankë ka kodin e vet identifikues (8 e më shumë shkronja/shifra, prej të cilave shkronja e 5-të dhe e 6-të e identifikon shtetin ku gjendet banka). 2 nga 7 bankat komerciale në Kosovë shfrytëzojnë Kodin e Serbisë dhe Malit të Zi (CS për shifrën 5 dhe 6 të swift kodit, më parë YU), të tjerat bazohen në ridrejtimin e pagesave në banka të tjera, rrjedhimisht duke rritur provizionet për qarkullim ndërkombëtar të pagesave.

9. Pamundësia e sportistëve kosovarë për pjesëmarrje në arenën ndërkombëtare lidhet me mospranimin e federatave kosovare të sporteve gjëgjëse në ato ndërkombëtare. Përfundimisht bën Federata e Hendbollit dhe Ping-pongut, të cilat pas shumë mundimeve arritën vetëm statusin e vëzhguesit. Vazhdon izolimi i sportit kosovar, jo si absurd, por si konsekuencë e josovranitetit. Për më tepër, për shkak të mungesës së sovranitetit, shahisti kosovar Murtez Hondozi në garat e Kampionatit Evropian në Varshavë të Polonisë ka përfaqësuar për një javë SMZ-në pa fajin e tij...

10. Përderisa në Kosovë pranohej targarat e automjeteve nga Serbia, nuk vlen anasjelltas. Kjo, për mungesë sovraniteti, për shkak politik por edhe për motive ekonomike. Sepse duke qenë kësajsoj, Serbia mund të eksportojë mallra në Kosovë, ndërsa Kosova nuk mund të eksportojë mallra në Serbi.

(Vijon në numrin e ardhshëm)